

Këshilla rreth përdorimit të maskave:

- Lani duart!



- Mos prekni fytyrën!



- Hidheni maskën me 1 përdorim direkt në kosh!



- Mbajeni maskën në një këllëf pambuku kur e fusni në çantë, si dhe lajeni sa më shpesh me ujë të ngrohtë dhe sapun. Maskat e qepura vetë ta ofrojnë këtë mundësi.



MBROJTJA NDAJ COVID-19

QEPJA E MASKAVE



Materiali në vijim do t'ju vijë në ndihmë nëse doni të qepni maskat në kushtet e shtëpisë. Mbajtja e maskave është shumë e rëndësishme!

Për këtë arsy, duke ndjekur hapat e shpjeguara me tekstu dhe të ilustruar me foto, ju mund të krijoni vetë maska, duke qëndruar të sigurtë, të shëndetshëm dhe duke mos rënduar ekonominë e familjes.



Kjo broshurë është realizuar në kuadër të projektit ``Fëmijët në qendër të politikave lokale të mbrojtjes sociale``, zbatuar nga YWCA of Albania, me mbështetjen e UNICEF dhe USAID.



Hapi 1

Për të qepur maskën është e nevojshme të keni copa pambuku, gjilpërë, pe dhe llastik. Copat e pambukut mund të jenë nga rroba që nuk i përdorni më ose mund t'i blini në një dyqan metrazhesh. Për të bërë 3 maska për secilin anëtar të familjes ju duhet 0,2 metra pambuk.

Hapi 2

Prerja. Priteni copën që keni zgjedhur për maskë në dy pjesë kryesore: në pjesën e jashtme dhe të brendshme.



Hapi 3

Shtrijeni gjerësish pjesën e jashtme të maskës. Sipër saj vodosni pjesën e brendshme dhe qepni dy skajet që përputhen: pjesën lart dhe pjesën poshtë.



Hapi 4

Qepni edhe pjesën e mbetur të kontureve. Kujdesuni që qepjet të jenë të vogla dhe uniforme.



Hapi 5

Krijoni 4 cepa tek pjesa e jashtme dhe palosini në drejtimin e kundërt.




Hapi 6

Qepni pjesën e mbetur të pjesës së dukshme të maskës ku krijuat cepat, me qëllim krijimin e hapësirës për të vendosur llastikun mbajtës.



Hapi 7

Vendosni llastikun tek pjesa që sapo qepët.



Hapi 8

Lidhni dhe tërhiqni llastikun, aq sa e keni të nevojshme për të mbajtur maskën. Përsëriteni veprimin tek të dyja anët.



Hapi 9

Lajeni maskën para përdorimit dhe mbajeni sa më të pastër.

